

FTESË

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

**Grupi i Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e
Konsumatorit)**

**Sesioni 4: Sfidat e mbrojtjes së konsumatorit në
raport me evoluimin e inteligjencës artificiale**

28 shkurt 2023; 11:00 – 13:00

Format hibrid

Europe House dhe në Platformën Zoom

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në bashkëpunim me Slovak Foreign Policy Association dhe me mbështetjen financiare të SlovakAid ju fton në Sesionin 4, të Grupit të Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit) me temë “Sfidat e mbrojtjes së konsumatorit në raport me evoluimin e inteligjencës artificiale” që po organizohet në kuadër të Konventës Kombëtare për Integrimin Europian 2021- 2023.

Konventa fokusohet në 3 drejtime kryesore: 1) rritja e pjesëmarrjes së të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare (përfshirë edhe nivelin lokal); 2) institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe ato të biznesit; dhe 3) forcimi i kapaciteteve në negociatat për integrimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me ministritë dhe agjencitë kyçe gjatë periudhës 2014-2021 si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit etj. janë krijuar disa grupe pune për të adresuar kapitujt më sfidues të negociatave të acquis së BE-së. Deri më tani janë organizuar më shumë se 40 sesione të grupeve përkatëse të punës dhe 4 aktivitete plenare, në të cilat ekspertë vendas dhe më shumë se 20 ekspertë nga Sllovakia kanë ndarë përvojën dhe ekspertizën e tyre. Këto sesione kanë mbledhur më shumë se 500 përfaqësues nga institucionet shtetërore (ministritë, institucionet publike qendrore dhe lokale), nga sektori i shoqërisë civile, komuniteti i biznesit dhe shoqatat e punëtorëve, akademia dhe media, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga organizma të huaj dhe organizata ndërkombëtare në Shqipëri.

Gjatë Konventës 2021–2023 po organizohen 16 sesione për katër Grupe Pune, më konkretisht: **GP I** – Gjqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); **GP II** – Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); **GP III** –Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11, 12 dhe 28); **GP V** – Çështjet e Tregtisë dhe Ekonomisë (Kapitulli 1, 2, 3, 4 dhe 20). Në këtë sesion, me kontributin e ekspertëve vendas dhe atij sllovak do të diskutohen sfidat e mbrojtjes së konsumatorit në raport me evoluimin e inteligjencës artificiale, direktivat e BE-së, rasti i Sllovakisë dhe situata në vendin tonë.

***Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj fizike në: info@em-al.org deri ditën e hënë, datë 27 shkurt 2023.**

Aktivitetin gjithashtu mund ta ndiqni online në Platformën Zoom:

Zoom Link:

<https://us06web.zoom.us/j/88582412349?pwd=eGREekRsRy9WcmowK0ovamxudFJjUT09>

Meeting ID: 885 8241 2349

Passcode: NCEI-AL

PROGRAMI

Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

Grupi i Punës III (Zhvillimi Rural dhe Mbrojtja e Konsumatorit)

Sesioni 4: Sfidat e mbrojtjes së konsumatorit në raport me evoluimin e inteligjencës artificiale

28 shkurt 2023; 11:00 – 13:00

Format hibrid

Europe House dhe në Platformën Zoom

10:50– 11:00 Regjistrimi i pjesëmarrësve

11:00 – 11:20 *Hapja e aktivitetit*

Gledis Gjipali, Drejtor Ekzekutiv/Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

Fjalë përshëndetëse

Jeta Deda, Drejtore e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (AKU).

11:20 – 11:50 **Mbrojtja e Konsumatorit në Shqipëri**

Granit Sokolaj, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës ALERT

-Rreziqet e përditshme të konsumatorëve dhe masat nga institucionet respektive

-Përmirësimi i legjislacionit e përafrimi me atë të BE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorit

11:50 – 12:20 **Eksperiencia e Sllovakisë si vend anëtar i BE-së për sfidat e mbrojtjes së konsumatorit në raport me evoluimin e inteligjencës artificiale**

Zuzana Motúzová nga Motúzová & Lacko Law company/Slovakia

-Inteligjenca artificiale dhe mbrojtja e konsumatorit në BE dhe veçanërisht në Sllovakia

-Direktivat e BE-së dhe boshllëqet e paplotësuara për mbrojtjen e konsumatorit

-Rekomandime për Shqipërinë

12:20 – 12:40 *Diskutim i hapur me pjesëmarrësit*

12:40-13:00 **Mbyllja e takimit dhe koktejt**